

VENDIM
Nr. 124, datë 16.8.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË
PËRKOZHSHME PËR MEKANIZMIN BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 98 dhe 100 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 19, pika 1, germa “f” dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për draftrregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën e tij nr. 4176 Prot., datë 1.8.2017, paraqiti në ERE për miratim draftin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike.

- Rregullorja është hartuar nga OST sh.a. në përputhje me nenet 98 dhe 100 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- OST sh.a., në shkresën e sipërcituar ka bërë me dije se drafti i këtyre rregullave është përgatitur me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në kuadër të mbështetjes teknike të ofruar për këtë qëllim.

- Në kuadër të kësaj asistence, procesi i draftimit të këtyre rregullave ka përfshirë edhe organizimin e seminareve e takimeve të përbashkëta me palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti